

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 DHE SPORTIT
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2025

KUALIFIKIMI PROFESIONAL "SHËRBIME SOCIALE DHE SHËNDETËSORE"

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8
Pikët								
Kërkesa	9	10	11	12	13	14	15	16
Pikët								
Kërkesa	17	18	19	20	21	22	23	24
Pikët								
Kërkesa	25	26	27	28	29	30		
Pikët								

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Pacientët zakonisht kalojnë nëpër pesë stade të sëmundjes. Stadi i parë përfshin: **1 pikë**
- A) Pranimin e sëmundjes
 - B) Përjetimin e simptomave
 - C) Kontaktin me kujdesin shëndetësor
 - D) Rolin e varur të pacientit
2. Apnea përfshin një çrregullim të rëndësishëm të respiracionit e cila karakterizohet nga: **1 pikë**
- A) Mungesa e respiracionit
 - B) Respiracione ciklike
 - C) Vështirësi respiratore
 - D) Inspiracion me zhurmë
3. Aftësia e patogjenit për të shkaktuar një sëmundje të rëndë quhet: **1 pikë**
- A) Infeksiozitet
 - B) Virulence
 - C) Patogjenicitet
 - D) Infeksion
4. Sëmundjet që shfaqen vazhdimisht gjatë gjithë vitit quhen: **1 pikë**
- A) Epidemi
 - B) Pandemi
 - C) Endemi
 - D) Proces epidemik
5. Infeksioni i traktit të poshtëm respirator që shfaqet gjatë apo pas hospitalizimit tek të sëmurët që nuk kanë pasur fazë të inkubimit të infeksionit në momentin e pranimit në spital, quhet: **1 pikë**
- A) Bronkit
 - B) Bronkiolit
 - C) Emfizemë pulmonare
 - D) Pneumoni nozokomiale
6. Procesi i sterilizimit realizohet nga një person i kualifikuar sipas protokolleve të punës dhe një programi të kontrolluar për sigurimin e cilësisë. Në sa faza realizohet ky proces: **1 pikë**
- A) 2 faza
 - B) 3 faza
 - C) 4 faza
 - D) 5 faza

7. Medikamentet me mbështjellje të veçantë ku futet bari për të maskuar shijen apo erën e keqe, quhen: **1 pikë**
- A) Kapsula
 - B) Mikstura
 - C) Specie
 - D) Tinktura
8. Sasia e tretësirës që do ti injektohet pacientit llogaritet me formulën: **1 pikë**
- A) $X=DxH:Q$
 - B) $X=HxD:Q$
 - C) $X=D:HxQ$
 - D) $X=QxD:H$
9. Epilepsia nënkupton një çrregullim të funksionit cerebral dhe trajtohet me barna: **1 pikë**
- A) Sedative
 - B) Diuretike
 - C) Antidepresive
 - D) Antikonvulsive
10. Laksativët janë substanca që veprojnë duke shpejtuar zbrazjen e aparatit tretës. Bisakodili është medikament që futet në grupin e laksativëve: **1 pikë**
- A) Stimulues
 - B) Volumformues
 - C) Lubrifikues
 - D) Kripore
11. Në përbërje të skeletit të njeriut numërohen rreth: **1 pikë**
- A) 200 kocka
 - B) 205 kocka
 - C) 210 kocka
 - D) 220 kocka
12. Muskuli më sipërfaqësor nga të gjithë muskujt e shpinës dhe që zë pjesën e sipërme të shpinës, quhet: **1 pikë**
- A) Muskuli romboid
 - B) Muskuli trapez
 - C) Muskuli subclavius
 - D) Muskuli pectoralis

13. Dallohen disa forma të stomakut. Forma më e zakonshme, normale dhe më e shpeshta që takohet është stomaku në formë: **1 pikë**

- A) Drapëri
- B) Dardhe
- C) Çengeli
- D) Sahati

14. Cipa e hollë e lëmuar që mbështjell gjithë hapësirat e zemrës nga brenda, duke marrë pjesë edhe në formimin e valvulave, quhet: **1 pikë**

- A) Perikardi
- B) Miokardi
- C) Endokardi
- D) Velum semilunare

15. Trakea është pjesë e rrugëve të frymëmarrjes, e cila paraqet vazhdimin e laringut dhe shtrihet nga: **1 pikë**

- A) Vertebra e VI cervikale deri në vertebrën e IV-V torakale
- B) Vertebra e VII cervikale deri në vertebrën e IV torakale
- C) Vertebra e VII cervikale deri në vertebrën e V torakale
- D) Vertebra e VI cervikale deri në vertebrën e VI torakale

16. Në planifikimin e shërbimeve shëndetësore efiçienca ekonomike konsiston në: **1 pikë**

- A) Përmirësimi i efiçencës së shpërndarjes së burimeve
- B) Ulja e financimit
- C) Ulja e dobisë neto të shoqërisë
- D) Përmirësimi i efiçencës operative

17. Parimi i shëndetit publik konsiston në: **1 pikë**

- A) Efiçienca e burimeve të financimit
- B) Qëndrueshmëria dhe vazhdimësia e zhvillimit të shoqërisë
- C) Përmirësimi i shëndetit të popullatës
- D) Barazia dhe solidariteti

18. Ekspozioni i kostos së shërbimeve shëndetësore ka të bëjë me: **1 pikë**

- A) Rritjen e shpenzimeve
- B) Rritjen e financimit
- C) Rritjen e fitimit
- D) Uljen e kostos

19. Funkzioni më i rëndësishëm i infermieres është: **1 pikë**

- A) Të evidentojë problemet e pacientit
- B) Të formulojë diagnozën
- C) Të plotësojë recetën mjekësore
- D) Të trajtojë pacientin

20. Njerëzit formojnë grupe për të përdorur përfitimet e shumta të tij. Modeli i Tuckman-it identifikon pesë faza të formimit të grupit. Faza e dytë përfshin: **1 pikë**

- A) Sulmin
- B) Normimin
- C) Formimin
- D) Performancën

21. Listoni më poshtë katër faktorët e brendshëm që ndikojnë në shëndetin e pacientit, duke ndikuar në mendimet dhe veprimet e tij. **4 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

22. Listoni më poshtë katër nga faktorët që mund të ndikojnë në shpejtësinë, ritmin dhe thellësinë respiratore. **4 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

23. Sterilizimi përfshin procesin e eliminimit të mikrobeve në masën 100%. Renditni më poshtë katër nga metodat e sterilizimit. **4 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

24. Ethe quhet rritja e temperaturës trupore së trupit mbi kufijtë e normës fiziologjike, të cilat ndahen në disa lloje. Listoni më poshtë katër prej tyre. **4 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

25. Lëngu i stomakut përmban acid klorhidrik, pepsinogjen, mukus, faktorin antianemik dhe elektrolitë të ndryshëm. Acidi klorhidrik ka katër funksione kryesore. Listoni më poshtë cilat janë ato: **4 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

26. Neuroni është qeliza funksionale e indit nervor. Klasifikimi funksional ndan neuronet në disa lloje. Listoni më poshtë katër prej tyre. **4 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

27. Barnat në formë tablete janë pluhura të komprimuara në makineri të posaçme. Listoni më poshtë katër nga arsyet pse tabletat janë një formë medikamentoze shumë e përdorshme: **4 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

28. Farmakologjia është shkenca që merret me studimin e barnave. Farmakologjia studion: **4 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

29. Marrëdhëniet ekonomike mes qeveri/shtet dhe familje/individë reflektohen në katër element. Listoni më poshtë cilët janë ato: **4 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

30. Renditni më poshtë katër parimet bazë etike të Shëndetit Publik të "ri": **4 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

